



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.473/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxha kryesues, Ferit Osmani dhe Vllastimir Dimiq anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër komisionarit të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Kujtim Shkodra dhe Agim Nuhiu për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

ARSYETIMI

Më datën 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se aktivistet e subjektit politik PDK me datën 12.12.2010 në orën 14:00 në Gjilan si dhe komisionarët PDK-se Kujtim Shkodra dhe Agush Nuhiu në “këmbim të votave ju japin mbushje të telefonave votuesve”. Parashtruesi i ankeses konsideron se kjo është shkelje ligjore.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankeses nuk ka bashkangjitur asnjë prove materiale..

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon se:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsitë e pretenduara. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 473/2010 më datën 14.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

